

Shtyhet thirrja për aplikime për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Çek të Shkencave të Jetës, në Republikën Çeke, për semestrin e parë të vitit akademik 2025 - 2026.

Në kuadër të programit Erasmus+ është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Çek të Shkencave të Jetës.

<https://www.czu.cz/en>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për traineeship në “Department of Agroecology and Crop Production”;

Nivelet e mobilitetit:

- Bachelor;
- Master;
- Doktoraturë.

Fusha e shkëmbimit:

- Gjeografi;

Programi i praktikës do të përqendrohet në:

- Përgatitjen dhe ofrimin e prezantimeve efektive të punës së tezës/disertacionit;
- Përpunimin e të dhënave duke përdorur softuerë statistikorë modernë;
- Kryerjen e rishikimeve gjithëpërfshirëse të literaturës duke përdorur bazat e të dhënave akademike.

Kohëzgjatja:

- 2 muaj (mobiliteti fillon në muajin nëntor)
- 3 muaj (mobiliteti fillon në muajin tetor);

Bursat përfshijnë:

-Kompensim mujor (850 EUR në muaj për studentët);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Listë notash të nivelit aktual dhe të mëparshëm të studimeve (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj;
- Learning agreement, sipas formatit:

[Learning agreement - traineeship 2023 \(KA131 -KA171\).docx](#)

Afati për aplikim: **14 gusht 2025**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!